

ENVER HYSA

RRETH PËRDORIMEVE TË SË PAKRYERËS SË DËFTORES NË GJUHËN SHQIPE

Ndër çështjet pak të studjuara të gramatikës shqipe janë dhe përdorimet e kohëve foljore, të cilat gjer më sot nuk janë bërë objekt i një trajtimi të imtë¹, qoftë në planin e formave, qoftë në atë të kuptimeve.

Në këtë artikull ne do të mundohemi të trajtojmë shkurt përdorimet e së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe. Jemi përpjekur t'i vështrojmë përdorimet e saj në mënyrë të krahasuar me ndonjë kohë tjetër me të cilën afrohet si nga përdorimi ashtu edhe nga pikëpamja e vlerave aspektive që fitojnë në disa përdorime kohët e foljes në gjuhën shqipe.

Përdorimet e së pakryerës nuk janë bërë herë tjetër objekt i një trajtесе më vete. Vetëm në gramatikat me karakter shkollor është shkruar për vlerat e saj. Në mënyrë më të gjerë janë trajtuar përdorimet e vlerat e së pakryerës në gramatikat e K. Cipos² dhe të Sh. Demirajt³. Në këto gramatika janë nxjerrë në pah përdorimet themelore të saj, por vendi dhe qëllimi nuk i kanë lejuar autorët të zbulojnë e të zbërthejnë me hollësi të gjitha vlerat e përdorimet që ka e pakryera në shqipe. E pakryera gjithashtu nuk është vështruar në krahasim me kohët e tjera, sidomos me të tashmen me të cilën afrohet në përdorim.

*
* *

Dihet se e pakryera nëpër dialektet dhe të folmet e ndryshme të shqipes ka një larmi të madhe formash, disa me një shtrirje mjaft të

1) Studime të veçanta për kohë të ndryshme të foljeve në gjuhën shqipe janë ndërmarrë nga autorë të ndryshëm. Këtu po përmendim: Gr. Brincuş, *Despre valoarea aoristului in albanezã* në «Studi şi cercetări lingvistice», 1960, 1, f. 61-72; Norbert Boretzky, *Perfekt und Plusquamperfekt in einem nordostalbanischen Dialekt*, në «Beiträge zur Südosteuropa-Forschung» 1966, f. 93 v.; A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, në «Studime filologjike» 1968, nr. 1, f. 59-74; F. Agalliu, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, në «Studime filologjike» 1968, nr. 2, f. 129-136; Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore*, në «Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme» Tiranë 1972, f. 254-275.

2) K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1949, f. 112-113; *Sintaksa*, Tiranë 1952, f. 41, 53.

3) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Pjesa II, Tiranë, 1963, f. 200-202.

gjerë, disa të kufizuara në një dialekt a në një grup më të vogël të folmesh⁴.

Por, pavarësisht nga ndonjë luhatje që vjen si pasojë e moszotërimit të plotë nga ana e shkrimtarëve të normave të gjuhës letrare, sot mund të thuhet se format e së pakryerës, që janë ngritur në normë janë: Forma veprare njëjës: veta I *-ja*, veta II *-je*, veta III *-te* dhe *-nte* (për foljet që mbarojnë me zanore); shumës: veta I *-nim*, veta II *-nit*, veta III *-nin*. Forma pësore-vetvetore, njëjës: veta I *-(h)esha*, veta II *-(h)eshe*, veta III *-(h)ej*, shumës: veta I *-(h)eshim*, veta II *-(h)eshit*, veta III *-(h)eshin*.

Siç shihet, duke përgjithësuar dhe duke ngritur në normë këto mbaresa, gjuha letrare ka mënjanuar nga përdorimi format e shumta të mbaresave të vetave të ndryshme që vihen re nëpër dialektet e nëndialektet e shqipes. Deri vonë si variante të normës janë konsideruar vetëm format e vetës së tretë njëjës të zgjedhimit pësor-vetvetor: *-(h)ej* dhe *-(h)esh*, të cilat kishin që të dyja një përdorim të gjerë edhe në gjuhën e shkruar edhe në gjuhën e folur, por sot ato kanë mbetur si variante dialektore, ndërsa në gjuhën letrare është përgjithësuar forma me *-(h)ej*.

* — *

E pakryera është kohë që i takon planit të së shkuarës, si e tillë ajo shpreh një veprim a gjendje që kryhet në një çast të caktuar të së shkuarës.

Veçori themelore e së pakryerës është se ajo e tregon veprimin në zhvillim e sipër, gjatë kryerjes, pa shënuar fillimin as mbarimin e tij. Në këtë drejtim ajo është e afërt me të tashmen, e cila tregon veprimin gjithashtu në zhvillim e sipër. Kështu e tashmja dhe e pakryera i kundërvihen së kryerës së thjeshtë dhe kohëve të tjera të së shkuarës që tregojnë veprime të mbaruara, të përfunduara në të shkuarën.

Kur kumtojmë diçka ne mund ta paraqesim këtë kumtim të lidhur me planin kohor të së tashmes, të së shkuarës e të së ardhmes. Vendosja e një raporti të caktuar midis veprimit ose gjendjes së kumtuar dhe planit kohor të përcaktuar, që merret si bazë për marrëdhëniet kohore, përbën thelbin e kategorisë së kohës si kategori gramatikore. Nga ana tjetër veprimi foljor mund të lidhet jo vetëm me një plan të caktuar kohe, por edhe me një veprim tjetër foljor të të njëjtit plan kohor.

Kur e tashmja merret si pikëreferimi kohor, e pakryera tregon veprime që kanë ndodhur e janë zhvilluar në të shkuarën. Por duke ndryshuar këndin e vështrimit, duke e vendosur të pakryerën në raport me kohët e tjera të së shkuarës, ajo (e pakryera) del si qendër referimi kohor para së cilës qëndrojnë kohët e tjera të së shkuarës (e kryera e thjeshtë, e kryera etj.) dhe pas e ardhshmja e së shkuarës e cila përputhet formalisht me të tashmen e kushtores. Në këtë drejtim edhe për

4) Shih për këtë punimet dialektore botuar në revistat «Buletin për shkencat shoqërore», «Buletin i Universitetit shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore» dhe «Studime filologjike»; më përmbledhtas shih J. Gjinari: *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 138-143, 154-156.

ne është i pranueshëm cilësimi i së pakryerës si e tanishme brenda së shkuarës⁵.

E pakryera në vartësi nga konteksti dhe situata e ligjërit mund të shprehë:

1 — Një veprim të së shkuarës të palidhur me raporte vartësie me veprime të tjera të së shkuarës, i cili kap një periudhë kohe të pacaktuar duke mos treguar caqet kohore as të fillimit as të përfundimit të këtij veprimi. P.sh. *Shikonte e shikonte* ustai me një palë sy shqyer e çapluar nga llahtari, merak, pagjumi dhe zemrimi dhe *ngjante* në atë qëndrim . . ., sikur të çuditej edhe vetë me pasurinë që paskish patur (J. Xoxa, *Novela*, 1958, 153), *Rrinte* buzë detit Kozi, si i papunë që ish, edhe *mbante* vesh dallgën tek *buçiste e shprazte* në shkëmbenjtë e molos gjithë zemëratën e motit që koha kish marrë pas. (po ai, po aty, 138).

a) E pakryera përdoret për të shprehur veprime të së shkuarës në zhvillim e sipër, duke treguar kështu zgjatjen e tyre⁶ ashtu si e tashmja që e tregon veprimin në proces, të papërfunduar, që vazhdon ende në momentin e ligjërit. P.sh. Ata që e panë Skënderbenë në krye të këtyre kalorësve nuk e *harronin* kurrë dhe e *mbanin* në gojë tërë jetën. (F. Noli, *Historia e Skënderbeut*, 1962, f. 98). Zogjtë *cicëronin*, *shpupurishin* pendët, *gufoseshin* dhe *ngroheshin* si të kishin rënë në gjumë. (R. T. Nepravishita, *Pelikanët ndërrojnë fole*, f. 3).

Le të krahasohet i njëjti përdorim i së pakryerës me të tashmen në shembujt: Sikurse shihet, ne me hapa të shpejta po e *nxjerrim* bujqësinë nga prapambetja dhe po e zhvillojmë atë mbi baza të shëndosha socialiste. (E. Hoxha, *Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut*, f. 20). Arësimtarët nuk duhet të harrojnë se çdo ditë, çdo orë *edukojnë* e pregatisin brezin tonë të ri. (E. Hoxha, *Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH në Kongresin IV*, f. 102).

b) Në disa raste e pakryera përdoret për të treguar veprime a gjendje që kanë filluar në një çast të caktuar të së shkuarës, çka përcaktohet nëpërmjet treguesve të ndryshëm kohorë dhe që vazhdojnë ende në çastin e ligjërit që merret si pikëreferimi kohor. P.sh. Tasi *kishte* dy vjet që e *mbante* plehun në kasolle nga frika e beut (F. Gjata, *Në prapagun e jetës*, f. 16).

Nga ana kuptimore gjithë konteksti lejon të kuptohet që gjendja vazhdonte ende në momentin e ligjërit. Në mënyrë të veçantë plotësori i kohës *dy vjet* tregon përafërsisht fillimin e kësaj gjendjeje në kohë në të shkuarën. E pakryera pra, në vartësi edhe nga kuptimi i tërë frazës, mund të tregojë një gjendje që është shfaqur në të shkuarën dhe që nuk ka përfunduar ende në momentin e ligjërit. Veprimi s'dihet me siguri sa ka zgjatur, dhe në një mënyrë ose në një tjetër ai lidhet me momentin e ligjërit. P.sh. Stefan Bardhi *kish* tri ditë me ethe, — një malarje e vjetër të cilën nuk e shkuli dot as kur punoi disa vjet nëpër shkollat e malësisë së Vërçës (Dh. Shuteriqi, *Çlirimtarët*, I, f. 7).

5) Shih për këtë: A. Dodi, *art. i cit.*, f. 65; F. Agalliu, *art.cit.*, f. 130; Sh. Demiraj *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe, Morfologjia* (maket) III, Tiranë 1971, f. 47 shih dhe po këtë autor, *art. i cit.*, f. 259.

6) Shih dhe K. Cipo, *vepër e cituar*, f. 112 e Sh. Demiraj, *vepër e cituar*, f. 200.

Ky përdorim i së pakryerës është i njëjtë me atë të së tashmes gjë që duket shumë qartë po të ndryshojmë planin kohor. Në të dy shembujt e mësipërm e tashmja, që me ndërrimin e planit kohor do të zëvendësonte të pakryerën, ka të njëjtin kuptim me të pakryerën.

Krahaso:

«Tasi ka dy vjet që e mban plehun në kasolle etj. dhe «Stefan Bardhi ka tri ditë me ethe . . .».

Caku i një veprimi të shprehur me të pakryerën mund të tregohet edhe me një fjali të varur kohore të ndërtuar zakonisht me lidhëzën *gjër sa*, e cila e ka gjithashtu kallëzuesin në të pakryerën. P.sh. Jeniçerët me oficerët e tyre *shërbenin* në ushtri *gjër sa plakeshin* dhe pastaj lëshoheshin me pension. (F. Noli, Historia e Skënderbeut (1962), f. 24).

Në mënyrë të veçantë zgjatjen e veprimit në të pakryerën e japin foljet durative si *vazhdoj*, *shtoj*, *dridhem* etj. P.sh. Njerëzit *vazhdonin* të grumbullohen e të shtyhen (të grumbulloheshin e të shtyheshin, E. H.), shpotitë *shtoheshin*, unë *dridhesha* pa pushim në pallton time... (Dh. Shuteriqi, Kënga dhe pushka, f. 411).

E pakryera si dhe e tashmja mund të shoqërohen edhe me pjesëzën *po*. K. Cipo ka shprehur mendimin që trajtat e së tashmes dhe të së pakryerës, kur janë të pashoqëruara me këtë pjesëzë «tregojnë veprim të pacaktuar, abstrakt, të përgjithtë ose të përsëritur», por «kur duam që të kemi veprim konkret dhe të caktuar përdorim pjesëzën *po*»⁷. Me fjalë të tjera, veprimi i shprehur nga folja në të pakryerën ose në të tashmen, kur nuk është i shoqëruar me pjesëzën *po*, është një veprim i pacaktuar, ndërsa kur është i shoqëruar me pjesëzën *po* është një veprim i caktuar. Pjesëza *po*, si e vë re edhe Sh. Demiraj⁸ shënon në mënyrë më të theksuar vazhdimësinë e veprimit kur nis ose kur mbaron një veprim tjetër i shprehur zakonisht me një kohë tjetër të së shkuarës. Pra pjesëza *po* e aktualizon veprimin, e paraqet atë në zhvillim e sipër. P.sh. Një pasdreke të vjeshtës së parë tek Leksi *po rrinte* e *po ruante* kopënë që *po gjimonte* faqe kodre barin e pakë të stinës koprace, një grua atje poshtë në fshat kish marrë arat e *po çante* misrin, pa pyetur gjë për buzët e mprehta thikë të bimës, që *po ia lëvrinin* mishrat gjak (J. Xoxa, f. 142). *Po punonte* në kopësht, kur fap doli ajo shtrigë, si lugati nga varri. (F. Gjata, Tana, f. 65).

Por pjesëza *po* mund të tregojë së bashku me të pakryerën edhe vetëm vazhdimësinë e veprimit në një çast të caktuar të së shkuarës p.sh. Kur ajo ndjenjë kënaqësie m'u përsërit i dhashë një kuptim të njëanshëm: *po më përmirësohej* shëndeti (V. Vinçani, Lumturia, f. 127).

Ndërkaq duhet shënuar se pjesëza *po* nuk është domosdo e detyrueshme për të shprehur në mënyrë të theksuar vazhdimësinë e zgjatjen e veprimit në të shkuarën e në të tashmen. Ka edhe raste, megjithëse jo të shpeshta, kur e pakryera, që nuk është shoqëruar me këtë pjesëzë, shpreh në të njëjtën mënyrë zgjatjen e veprimit e të gjendjes p.sh. E zaptoi këtë qytet dhe *gatitej* të hidhej kundër Romës (F. Noli, Historia

7) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, f. 113.

8) Kur duam ta vemë më tepër në dukje të zgjaturit e një veprimi konkret në një çast të caktuar të së shkuarës, foljen në të pakryerën e shoqërojmë me pjesëzën *po*, e cila e thekson edhe më tepër idenë e të zgjaturit të veprimit. P.sh. Kur vajtëm ne, ata *po hanin* e *po pinin* e *po këndonin*. Sh. Demiraj, *po aty*, f. 201-202.

Skënderbeut (1921), f. 279). Kur i afrohej Krujës mësoi që Jonuzi po vinte me një ushtëri për të forcuar rrethonjësit (po ai, po aty, (1962), 112-113).

Kjo tregon se pjesëza *po* është në disa raste vetëm një shoqëruese e shteme e së pakryerës që shpreh zakonisht veprime të së shkuarës që ngjasin për një kohë të pacaktuar.

Një formë tjetër që shpreh vazhdimësinë e veprimit në një çast të caktuar të së shkuarës dhe që del si zëvendësuese e së pakryerës me pjesëzën *po*, është konstrukti a shprehja foljore: *isha duke punuar*, ndërhuar me të pakryerën e foljes *jam* dhe një përcjellore. Po kështu edhe konstrukti analog *jam duke punuar* ka të njëjtën vlerë me të tashmen e thjeshtë të shoqëruar me pjesëzën *po*. P.sh. Kur i huaji ishte duke kallur kafshën në katroqet e konakëve, dhjaku u ngjit lart e na lajmëroi: «Po rrijen kapedani» (J. Xoxa, Novela, f. 10). Kur s'arrinte ta kapte telin me duar, e zinte me dhëmbë dhe e shtrëngonte me një pasion të tillë, sa të vinte mëndja se ishte duke shqyer armikun e tij më të tmershëm (N. Prifti, Çezma e floririt, f. 123).

Konstruktet *jam + përcjellore dhe isha + përcjellore* nuk janë të shpeshta në gjuhën letrare. Ato kanë një përdorim pak a shumë të gjerë e të shpeshtë në gjuhën e folur, sidomos nëpër dialekte, ku krahas tyre gjenden edhe disa konstrukte të tjera, të cilat nuk kanë arritur të ngrihen në normë e të përgjithësohen në gjuhën letrare, jo vetëm sepse kanë një shtrirje tepër të ngushtë dialektore por edhe sepse nuk sjellin ndonjë kuptim a nuancë kuptimore të re në krahasim me format e thjeshta korresponduese të kohëve përkatëse.

Gjuha shqipe zotëron edhe mjete të tjera leksikore, konstrukte të veçanta, për të dhënë vazhdimësinë e veprimit si për të tashmen edhe për të pakryerën si: *është në të ardhur e sipër, ishte në të ardhur e sipër* etj.

2. E pakryera përdoret për të treguar veprime të së shkuarës që janë përsëritur në intervale të caktuara⁹, ashtu si e tashmja e cila tregon gjithashtu veprime që përsëriten. Si në të tashmen, si në të pakryerën përsëritja përcaktohet kryesisht nga tregues kohorë, por përsëritja me intervale të caktuara mund të mos shoqërohet me tregues të ndryshëm kohorë. Është kuptimi i tërë frazës ai që jep këtë ide. Nganjëherë vetë kuptimi leksikor i foljes është i tillë që shpreh përsëritje. P.sh. *Nga koha në kohë përdorte* goditjet ofensive të guximta e strategjinë e farosjes si në betejën e Albulenës... (F. Noli, Historia e Skënderbeut (1962) f. 126). Duke vazhduar rrugën për te vendi ku kishim bërë mend t'u zinin pritë shpendëve grabitqarë, ata *thyheshin* e *përkuleshin*, anës udhës e *mblidhnin* marina. (J. Xoxa, Lumi i vdekur, v. II, f. 12). Edhe Teli, kohë më kohë, *hidhte* fshehtas vështrimin nga ana e Manushaqes dhe *shikonte* profilin e saj. (V. Kokona, Me valët e jetës, I, 317):

Krahaso për të tashmen: Pak nga pak, u mësova dhe tani që e kuptova se të gjitha këto janë tonat, *vete e vij* si në shtëpinë time (R. Brahim, Tregime, f. 91).

Me anë të mjeteve të ndryshme leksikore, sidomos me anë të ndajfoljeve, tregohet mënyra e përsëritjes. Kështu ndajfoljet *shpesh, shpesh-*

⁹ Shih për këtë edhe K. Cipo, *vepër e cituar*, f. 113, e Sh. Demiraj, *vep. e cit.* f. 201.

herë, herë-herë, rrallëherë, nganjëherë, ndonjëherë etj., tregojnë dendurinë e përsëritjes. P.sh. **Qëllonte shpesh** që Petritit t'i sosej durimi, t'i acaroheshin nervat dhe atëhere atij i dukej sikur kishte humbur dritën e syve. (A. Abdihoqha, *Një vjeshtë me stuhi*, f. 238). Ç'është e vërteta *shpeshherë habitesha* me trimërinë dhe guximin e tyre por mendoja se kjo ish karakteristikë e shqiptarit, (M. Kallamata, *Shokë lufte*, f. 5).

Me kuptimin e përsëritjes dhe të vazhdimsisë lidhet edhe kuptimi i së pakryerës që shpreh një veprim të zakonshëm, pak a shumë të qendrueshëm, të përhershëm. P.sh. Gjatë periudhës së dimrit, çdo të diel *ngjiteshin* në malin e Dajtit, ku *qendronin* deri vonë në mbrëmje.

*
* *
*

Nganjëherë e pakryera ia lëshon vendin formës së «kushtores» (së ardhmes në të shkuarën) për ta prurë veprimin a gjendjen si më të sigurtë, që do të realizohej me siguri në të shkuarën. Është për t'u shënuar këtu se i njëjti përdorim haset edhe në të tashmen e cila alternon me të ardhmen. Kështu krahas dy ose më shumë të pakryerash: Më kujtohet se sa herë *vija* në mal mblihdhja nga një tufë lulekaçesh e ja *sillja* motrës së vogël. (N. Prifti, *Çezma e floririt*, f. 162), përdoret edhe një e pakryer shoqëruar me formën e së ardhmes në të shkuarën: Është djalë i mirë thoshte me mburrje dhe sa herë *kthehesha* nga qyteti, *do të më pyeste* për të (N. Prifti, *Tregime të fshatit*, f. 61). Sa herë që *shkonte* në Korçë ditët e pazarit, *do ta takonte medoemos*. (S. Spasse, *Ata nuk ishin vetëm*, f. 10).

Po kështu edhe në të tashmen: E tani sa herë *vjen* nëntori, më kujtohet ajo që ndjeva ato çaste i vetëm në mes të oborrit. . . (Gj. Zhei, *Bizilja*, f. 41). Sa herë *dëgjoni* se aty afër ka ardhur ndonjë partizan ju *do të lini* çdo punë e *do të shkoni* ta takoni, se mos kush e di ai është djali juaj, se mos kush e di lajmet që kini marrë janë të gënjeshtra. (F. Gjata, *Përmbysja*, f. 315).

Për sa i përketë sferës së përdorimit duhet shënuar se ky është më fort i shqipes popullore se sa i gjuhës letrare. Ky përdorim vihet re në një periudhë me fjali kohore të ndërtuar me lokucionet lidhëzore *sa herë e sa herë* që.

3) E pakryera ndonjëherë ka vlerën e së kryerës së thjeshtë. Ajo përdoret në të tilla raste për të shprehur një veprim, i cili kryhet në një çast të caktuar të së shkuarës. Një përdorim i tillë i së pakryerës është i lidhur me faktin që ajo, duke treguar zakonisht një veprim të papërfunduar, në procesin e tij të kryerjes, në zhvillim e sipër, e paraqet atë më konkret se sa e kryera e thjeshtë që e përqëndron veprimin në një çast të caktuar dhe për këtë shkak nuk jep tabllonë e plotë të zhvillimit të tij. Përdorja e saj me vend i jep zhdërvjelltësi stilit të tregimeve për të cilin është karakteristik ky përdorim. P.sh. Kështu në kohën kur *Europa dilte* nga koha e mesme dhe *hynte* në Rilindjen e Qytetërisë, *Shqipëria shuhej* nga lista e shteteve të lira dhe *hynte* nën zgjedhën e urryer të një fuqie barbare, nën të cilën vuajti më tepër se katër shekuj. (F. Noli, *Historia e Skënderbeut* (1921), f. 278). Atë ditë.

sa pa vdekur Gjorg Kastrioti, *shkulej* Arbëri i tërë dhe *vinte* në Galigad (Dh. Shuteriqi, *Kënga dhe pushka*, f. 65). Këtë ditë, pikërisht kur Huniadi *kapërcente* grykat e Ballkanit, u pagëzua edhe Hamza Kastrioti, i biri i Stanishit, me disa shokë të tjerë, të ardhur nga fusha e Nishit (F. Noli, *Historia e Skënderbeut* (1950), f. 31).

4. E pakryera mund të përdoret edhe në vend të së tashmes së kushtores¹⁰, për të shprehur veprime të mundshme po ireale të së shkuarës. P.sh. A më sheh ti mua plaknë? / të qënkeshe si ti djalë / Muratit i *pinja* gjaknë / sot *s'gënjehesha* me fjalë. (N. Frashëri, *Hist. e Skënd.* (1953), f. 225). Ndë *dinja* se kur vdes, *bënja* varrin vetë (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, v. II, f. 23).

E pakryera në vend të së tashmes së kushtores përdoret zakonisht nëpër fjali kryesore që plotësohen nga një fjali e varur kushtore me foljen kallëzues në të pakryerën e lidhore e më rrallë, sidomos në gjuhën e folur popullore, në lidhore-habitore e në të pakryerën. Të mos kishe ata kalamaj që po më hanë sytë, *shkoja e luftoja* me Hekuranin. (Dh. Shuteriqi, *Rruga e rinisë*, f. 24). Ndë *dinja* se kur do vdes, *bënja* varrin vetë. (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, II, 23).

5. Përdoret e pakryera edhe kur duam të tregojmë dy a më shumë veprime që kryhen në të njëjtën periudhë kohe të së shkuarës. P.sh. Po plaka ime, sado që nuk ish mësuar të më bënte fjalën dy, më *hidhej* turije, kur i *flisja* kështu (Sh. Musaraj, *Të shkuara, të paharruara*, f. 12). Kur *qeshte i delte* trëndafil nga goja e kur *qante* i *rridhnin* margaritarë nga sytë, edhe e pëlqeu fort (Folklor shqiptar. Proza popullore, V. I, f. 163). Kur e *merrnin* me të mirë, *Xhafa zbutej* e *bëhej* vaj (A. Abdihoxha, *Tri ngjyra të kohës*, f. 67).

6. E pakryera përdoret për të treguar edhe një veprim që kryhet pas një veprimi tjetër në të shkuarën, i cili mund të jetë shprehur me një folje në të pakryerën ose në të kryerën e plotë. P.sh. E ai mbasi e *shikonte* mirë e mirë, e *hapte* paçavrën, e lagte dhe me aqë fuqi e fërkonte sa që tryeza loste vendit (Migjeni, *Vepra* (1961), f. 206). Ahere plakat e gratë që rrinin përpara portave, pasi *ishin kënaqur* me muhabet duke mbajtur nëpër gojë tërë botën, *merrnin* me vehte karriget e postet, *hynin* brenda dhe i *mbyllnin* dyert mirë (F. Gjata, *Këneta*, f. 78).

7. Mund të përdoret e pakryera për të treguar një veprim që vazhdon ende të kryhet në një çast të caktuar të kohës së shkuar, kur përfundon një veprim tjetër i shprehur me foljen në të kryerën e thjeshtë. P.sh. Kur Thoma Pojani *iu afrua*, ajo *po zihej* me fjalë me Tir Marën» (F. Gjata, *Tana*, f.25). Aeroplani i tij, siç thashë *u godit* nga kundrajrori kur *po largohej* pasi kish bombarduar qytetin. (I. Kadare, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1963), f. 37).

8. E pakryera përdoret jo rrallë, sidomos në gjuhën e folur, për të zbutur një kërkesë¹¹ ose për ta shprehur atë në formë lutjeje. Veç këtu duhet pasur parasysh se nuk është e pakryera si kohë e së shkuarës që ka aftësinë për të shprehur këtë kuptim. Ngarkesa semantike e vetë foljes është ajo që mban peshën kryesore në këtë kuptim. Kjo del më e qartë

10) Shih Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 215.

11) Shih Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 201.

po të shihet përdorimi i po atyre foljeve në kohë të tjera të së shkuarës, po edhe në të tashmen.

Të tilla janë foljet *dua*, *dëshiroj* edhe shprehja *kam dëshirë* etj. P.sh. *Donte t'i thotë se nesër mbrëma do t'u tregonte fshatarëve ato që kishte dëgjuar sot në konferencë.* (F. Gjata, Tana, f. 20). Në radhë të parë *doja* të të laja një borxh që të kisha, borxhin e asaj letrës. (Sh. Musaraj, Para agimit, II, f. 500). Me këtë vlerë përdoret po me këto folje edhe e kryera e thjeshtë, e cila ka një denduri më të madhe përdorimi se e pakryera.

Në të tilla raste e pakryera, ashtu si dhe e tashmja, përdoret për të mos e shprehur në një mënyrë kategorike, ose në një mënyrë të pasjellshme një mendim. Përdorimi i formës së pakryer në këtë rast lidhet me aftësinë që ka ajo për ta paraqitur veprimin jo tërësisht të mbaruar, të përfunduar.

Me vlerat dhe kuptimet e shumta që ka, e pakryera është një kohë që përdoret shpesh në letërsinë artistike, sidomos në stilin e tregimeve dhe në përshkrime.

Ajo gjen gjithashtu një përdorim të gjerë edhe në përrallat popullore. E pakryera tregon rrethanat e jashtme, që shoqërojnë veprimet kryesore të shprehura me kohët e tjera të së shkuarës, veçanërisht me të kryerën e thjeshtë, të kryerën dhe më se të kryerën.

R é s u m é

L'EMPLOI DE L'IMPARFAIT INDICATIF EN ALBANAIS

L'auteur examine, dans son article, les emplois et les valeurs de l'imparfait ainsi que sa construction en albanais littéraire actuel. L'imparfait est analysé en rapport étroit avec le présent, avec lequel il a plusieurs points de contact dans l'usage courant.

Pour les deux formes de l'imparfait dans les deux conjugaisons — active et passive ou pronominale —, l'auteur fait noter qu'indépendamment de quelque fluctuation, la langue littéraire a généralisé un couple de formes, en laissant à la périphérie la grande variété des désinences qu'on a, même de nos temps, dans les divers parlars de l'albanais.

L'imparfait est un temps qui appartient à un plan du passé. Sa particularité fondamentale, qui le distingue de tous les autres temps du passé, est celle d'indiquer l'action en cours, pendant qu'elle a lieu, sans indiquer ni commencement ni fin. Considéré en rapport avec les autres temps du passé, l'imparfait est comme un présent à l'intérieur du passé, devant lequel se situent les autres temps du passé (passé simple, passé composé, etc.), suivis par le futur du passé, un temps qui, au point de vue de la forme, concorde avec le conditionnel.

Plus loin l'auteur analyse les emplois et les valeurs de l'imparfait. Il y distingue le sens de continuité, de prolongement. Il fait noter que l'imparfait indique, des fois, une action commencée dans le passé, mais qui se continue jusqu'à l'instant de l'entretien.

L'imparfait, au même titre que le présent, peut s'associer à la particule *po*, qui actualise l'action, comme si elle avait lieu devant nos yeux.

L'auteur a traité aussi l'imparfait qui exprime une action répétée, que s'associe de différents indices temporels.

Le passé est employé également avec la valeur du passé simple pour présenter l'action en cours, à la différence du passé simple qui concentre son action à un instant donné en ne donnant pas ainsi le tableau complet de son développement.

L'imparfait est employé aussi avec la valeur du présent conditionnel pour extérioriser des actions possibles, mais irréelles du passé.

L'imparfait est employé dans une phrase indiquant des opérations contemporains du passé, ou bien pour indiquer une action qui a lieu après une autre action, en d'autres termes, il indique contemporanéité ou post-temporainéité dans le passé.

Il est employé aussi pour atténuer une demande, ou bien pour l'exprimer sous forme de politesse ou de prière.

L'imparfait est un temps qui, avec les valeurs et les nombreux sens qu'il extériorise, trouve un usage fréquent dans les narrations et les descriptions. Il fait état de circonstances extérieures qui associent les principales actions extériorisées avec les autres temps du passé, surtout avec le passé simple, le passé composé ou le plus-que-parfait.

